



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 61, datë 24.04.2019**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E NJË POZICIONI TË LIRË TË PËRKOHSHËM PËR TRANSFERIM NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, dhe në kërkesën e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, kërkesë e regjistruar me aktin nr. 46 prot., datë 17.01.2019,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Të autorizojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm lidhur me procedurën e transferimit të përkohshëm me dhe pa pëlqim të gjyqtarit, bazuar në përcaktimet e vendimit nr.23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.
3. Të përcaktojë gjykatat e rretheve gjyqësor Tiranë dhe Durrës, si gjykata nga të cilat do të kryhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari për të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**